V E N D I M
Nr.160, datë 30.10.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 30.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.62 Akti që i përket:

Kërkues:BESNIK ALLA, përfaqësuar nga avokat Viktor Ikonomi, me prokurë.
Objekti:Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.263, datë 8.5.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit është antikushtetues dhe kërkon shfuqizimin e tij duke paraqitur këto shkaqe:
Ndonëse në rekurs janë ngritur shkaqe që parashikohen në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore duke na mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.
Vendimi vjen në kundërshtim me ligjin, si përsa i përket kualifikimit ligjor të veprës, dhe masës së dënimit të dhënë.
I pandehuri nuk ka patur për qëllim kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 102/1 të Kodit Penal, por ka qenë një grindje e çastit.
I pandehuri duhet të përgjigjet për veprën penale të parashikuar në nenin 90 të Kodit Penal.
E dëmtuara ka hequr dorë nga ankimi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, përfaqësuesin e kërkuesit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

Kërkuesi Besnik Alla ka ushtruar rekurs pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë kundër vendimeve nr.793, datë 13.12.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe nr.35, datë 29.1.2001 të Gjykatës së Apelit të Tiranës, duke parashtruar shkaqe ligjore që lidhen me cilësimin e gabuar ligjor të veprës penale të kryer nga kërkuesi, masën e dënimit, pushimin e çështjes, sepse e dëmtuara ka hequr dorë nga ankimi.
Megjithë shkaqet e paraqitura, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale.
Vendimi i Gjykatës së Lartë vjen në kundërshtim me nenin 42 pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, duke shkelur të drejtën themelore të kërkuesve për një proces të rregullt gjyqësor dhe nenin 43 të Kushtetutës për të drejtën e ushtrimit efektiv të ankimit në një gjykatë më të lartë.

Kjo për faktin se shqyrtimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit është i ndryshëm nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore. Bazueshmëria në ligj e shkaqeve të parashikuara nga kërkuesi në rekursin e paraqitur prej tij, mund të gjykohet vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore.

Përsa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që janë paraqitur shkaqe ligjore, i ka mohuar kërkuesve të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar në seancë gjyqësore, duke mos u garantuar kështu zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës, ,si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.263, datë 8.5.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.